

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti juridik
Titulli i lëndës:	Të drejtat dhe liritë individuale
Niveli:	LLM
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Gjyljeta Mushkolaj
Detajet kontaktuese:	kab. Nr. 18, kati 5
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Ky kurs trajton të drejtat dhe liritë individuale të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjithashtu krahason procesin e hartimit të kushtetutës, idenë e ndarjes së pushtetit, mekanizmat për mbrojtjen e lirive individuale në Kosovë, Gjermani, dhe në Shtetet e Bashkuara.</p> <p>Pjesa një paraqet idenë e lirive dhe të drejtave nga perspektivat historike, filozofike, dhe analitike.</p> <p>Pjesa dy, pjesa kryesore e kursit, i dedikohet studimit të të drejtave dhe lirive individuale nën Kushtetutën e Kosovës. Kjo pjesë studion të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç rregullohet me instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, të drejtën ndërkombëtare zakonore, dhe burimet e tjera të të së drejtës ndërkombëtare.</p> <p>Pjesa tre trajton çështjet lidhur me liritë dhe të drejtat individuale nga perspektiva krahasuese.</p> <p>Kursi do të kombinojë ligjëratën e profesorit me diskutim në klasë. Kreditë për kursin do të bazohen në pjesëmarrje në klasë, leximin e materialeve të caktuara, punimet seminarike dhe provimin final.</p>
Qëllimet e lëndës:	Edhe pse kurset e zgjedhura për Programin kushtetues dhe administrativ mbulojnë çështje relevante për të drejtat dhe liritë individuale, ka nevojë për një kurs të veçantë ku do të trajtohen të drejtat dhe liritë individuale në nivel ndërkombëtar, evropian dhe kombëtar në mënyrë gjithëpërfshirëse. Sot në Kosovë, njohuria e të drejtave dhe lirive individuale është me rëndësi për ata që janë të regjistruar në programin kushtetues dhe administrativ.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët do të kuptojnë ndikimet kryesore historike,

	<p>politike, ligjore dhe morale që e kanë formësuar idenë e të drejtave dhe lirive individuale;</p> <p>Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë sfidat bashkëkohore dhe trendet në teorinë dhe praktikën e të drejtave të njeriut, dhe zbatimin e të drejtave në kontekstin kushtetues vendor;</p> <p>Studentët do të jenë përgjithësisht të vetëdijesuar për ndikimin e të drejtës ndërkombëtare në garantitë kushtetuese të lirive dhe të drejtave individuale.</p> <p>Studentët do të kuptojnë procesin e kushtetutë -bërjes në Kosovë, dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave individuale dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.</p> <p>Studentët do të fitojnë njohuri për instrumentet kryesore të të drejtave të njeriut të zbatueshme në Republikën e Kosovës;</p> <p>Studentët do të kuptojnë ndikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.</p> <p>Studentët do të dinë si të hulumtojnë dhe ku të gjejnë materiale për të drejtat e njeriut dhe çështjet përkatëse, dhe si të ndërtojnë dhe mbrojnë argumentet efektive kushtetuese duke përdorur precedentin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.</p> <p>Studentët do të njohin dispozitat kushtetuese që lidhen me lirinë e të shprehurit, lirinë e tubimit dhe të asociimit, si dhe lirinë e shtypit, pluralizmin e medieve, etj.</p>
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	14 javë	28
Ushtrime teorike/laboratorike	1	14j javë	14
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5		5
Ushtrime në teren	1	1 javë	1
Kollokfiume,seminare	4	1 jave	4
Detyra të shtëpisë	5	1 jave	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14 javë	28
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1 jave	3

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1	3
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			91
Metodologjia e mësimdhënies:			
	<p>Sesionet e lëndës përbëhen nga ligjëratat, diskutimet në klasë dhe një prezantim gojor pesë minutësh nga secili student gjatë semestrit. Studentët pritet të kenë lexuar materialet e caktuara para orëve të klasës, për të arritur në kohë dhe të jenë të përgatitur për të marrë pjesë plotësisht në diskutimet në klasë. Studentët kërkohet të marrin pjesë në të gjitha klasat, sepse kolokuiumi dhe provimi përfundimtar do të përfshijë pyetje në lidhje me materialet e mbuluara vetëm në orët e ligjëratave dhe të ushtrimeve, si dhe materiale nga lexime të caktuara si detyrë. Pjesëmarrja në ligjëratat është e detyrueshme dhe do të mbahet evidencë e prezencës së studentëve.</p>		
Metodat e vlerësimit:			
	<p>Nota përfundimtare në këtë lëndë do të përcaktohet si vijon:</p> <p>10% - Pjesëmarrja aktive (nëpërmjet të diskutimeve) në ligjëratat dhe në ushtrime</p> <p>10% - Prezantimi gojor</p> <p>10% - Një ese prej pesë faqesh e dorëzuar para prezantimit gojor (në të njëjtën temë)</p> <p>30% - Kolokuiumi</p> <p>40% - Provimi final</p>		
Literatura			
Literatura bazë:			
	<p>Benedek, Wolfgang, and Minna Nikolova, eds. <i>KUPTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DORACAK MBI ARSIMIMIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT</i>. Vienna: MANZ CROSSMEDIA, 2003. Print.</p> <p><i>Manualet e Botuara në serinë e "Manualeve Të Të Drejtave Të Njeriut"</i>. Strasbourg, France: Drejtoria E Përgjithshme E Të Drejtave Të Njeriut Këshilli I Evropës: Manuali Nr.1: E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001) Manuali Nr.2: Liria e Shprehjes. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001) Manuali Nr.3: E drejta për një proces të drejtë gjyqësor.</p>		

	<p>Një udhëzues për zbatimin e Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001) Manuali Nr.4: E drejta e pronës. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001) Manuali Nr.5: E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2002) Udhëzuesi Nr.6: Ndalimi i torturës. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut</p> <p>Dorsen, Norman, Michel Rosenfeld, András Sajó, and Susanne Baer. <i>Comparative Constitutionalism: Cases and Materials</i>. St. Paul: Thomson/West, 2003.</p> <p>Lexuesi i përgatitur për kursin</p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Donnelly, Jack. <i>Universal Human Rights in Theory and Practice</i>. New Delhi: Manas Publications, 2005.</p> <p>Kommers, Donald P. <i>The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic Of: Germany:3rd Revised Edition</i>. North Carolina: DUKE UNIVERSITY PRESS, 2013.</p> <p>Saksena, K. P. <i>Human Rights and the Constitution: Vision and the Reality</i>. New Delhi: Gyan, 2003.</p> <p>Schwabe, Jürgen, Stefanie Ricarda Roos, and Nina Catherine Schneider. <i>Vendime Të Përzgjedhura Të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane: Botim Jubilar</i>. Tirana: KAS, 2010.</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Mbrojtja Ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave të njeriut." <i>Doracaku për përgaditjen e provimit të jurisprudencës</i>. Prishtinë: Ministria e Drejtësisë dhe UNDP, 2009.</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Mbrojtja evropiane e lirive dhe të drejtave të njeriut." <i>Doracaku për përgaditjen e provimit të jurisprudencës</i>. Prishtinë: Ministria e Drejtësisë dhe UNDP, 2009.</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Local Government and the Right to Freedom of Association." <i>Kosovo Decentralization Dialogue</i>, LGI/OSI Budapest, and KFOS Prishtina, 2006, Prishtinë</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Këshilli i Evropës dhe mbrojtja e Lirive dhe të drejtave të njeriut", <i>Manual për përgaditjen e provimit të jurisprudencës</i>, Prishtinë, OSCE dhe Kosovar Institute for Euro-Atlantic Integration, 2004, Prishtinë.</p>

	Mushkolaj, Gjyljeta, Eralda Metasani, and Theodor Orlin. <i>Human Rights Glossary Albanian English/ English Albanian</i> . Tirana: UNESCO. Print.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Drejtësia dhe koncepti i të drejtave dhe lirive individuale Reflektime historike Idetë moderne
Java e dytë:	Pozita kushtetuese e të drejtave dhe lirive individuale Çfarë të drejtash të shprehura ekzistojnë në kushtetutë? Çfarë të drejtash të nënkuptuara ekzistojnë në kushtetutë? Doktrina e të drejtave themelore
Java e tretë:	Mbrojtja relevante ligjore ndërkombëtare e të drejtave dhe lirive individuale Marrëdhënia ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme në Kosovë
Java e katërt:	Konventa evropiane për të drejtat e njeriut Zbatimi i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut Rëndësia e të drejtës precedentale në Gjykatën evropiane të të drejtave të njeriut gjatë interpretimit të Kapitullit të të drejtave të njeriut në Kushtetutën e Kosovës
Java e pestë:	Liria e fjalës Bazat e doktrinës moderne Çfarë lloji i “fjalës” mbrohet? Çka përbën fjalën simbolike? Pse konsiderohet liria e fjalës si liri themelore civile? Cilat janë kufizimet legjitime ndaj të drejtës së lirisë së fjalës
Java e gjashtë:	Liria e asociimit dhe e mos asociimit Mbrojtja kushtetuese dhe korniza ligjore Vendimet monumentale të GJEDNj
Java e shtatë:	Mbrojtja e barabartë dhe kushtetuta Rishikimi i bazës racionale Komunitetet joshumicë dhe Kushtetuta Veprimi afirmativ
Java e tetë:	Barazia dhe diskriminimi gjinor Dallimi ndërmjet barazisë formale dhe përmbajtjesore Çka do të thotë diskriminimi direkt? Çka përfshin diskriminimi indirekt?
Java e nëntë:	Kollokuium
Java e dhjetë:	Barazia dhe diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara Mbrojtjet në dispozicion përkitazi me diskriminimin e personave

	me aftësi të kufizuara.
Java e njëmbëdhjetë:	Liria e tubimit dhe e protestës publike A është e drejta për t'u tubuar e drejtë individuale apo e drejtë grupore? Si rregullohet e drejta për t'u mbledhur në Kosovë? Cilat janë kufizimet e lejueshme ndaj të drejtës për të protestuar?,
Java e dymbëdhjetë:	Hyrje në mbrojtjen, zbatimin dhe monitorimin e të drejtave të njeriut: Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin universal dhe evropian të të drejtave të njeriut (EHRS): historia, akterët, instrumentet, rëndësia e EHRS për Evropën Jug-Lindore Politika e Bashkimit Evropian për të drejtat e njeriut. Këshilli i Evropës: Standardet dhe procedurat për zbatimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Mekanizmi i Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës Karta Sociale Evropiane.
Java e trembëdhjetë:	Standardet dhe procedurat e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut të OSBE-së, Komisionarit të Lartë për Minoritetet dhe të ODIHR-it. Standardet dhe Instrumentet e Bashkimit Evropian për Monitorimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; Agjencia e të drejtave themelore.
Java e katërbëdhjetë	Konkludimet përfundimtare

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtria dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor.	